



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V

Sesioni pranveror

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport

Mbledhja nr.41

Prishtinë, më 16.2.2016, në orën 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

PROCESVERBAL

**I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ARSIM, SHKENCË, TEKNOLOGJI,
KULTURË, RINI DHE SPORT**

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, kryetar, Salih Morina, Sërgjan Popoviq, Shpejtim Bulliqi dhe Bekim Haxhiu.

Munguan: Ismajl Kurteshi, Teuta Haxhiu, Shukrije Bytyçi dhe Mufera Shinik.

Pjesëmarrës të tjerë: përfaqësues të mediave, NDI, KDI.

Stafi mbështetës i Komisionit: Lule Ymeri dhe Shaip Goxhuli.

Mbledhjen e kryesoi: Nait Hasani, kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky

rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 9.2.2016;
3. Shqyrtimi i Planit të punës së Komisionit për vitin 2016;
4. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës;

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 9.2.2016;

Procesverbali nga mbledhja e mbajtur më 9.2.2016, u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Planit të punës së Komisionit për vitin 2016;

Nait Hasani, kryetar, tha se programi legjislativ i Qeverisë së Republikës së Kosovës për vitin 2016, parasheh të procedojë projektligje në kuadër të veprimtarisë së punës që mbulojnë fushat e arsimit, kulturës, trashëgimisë dhe sportit. Bazuar në këtë program legjislativ, është hartuar plani i punës së Komisionit për vitin 2016. Në kuadër të këtij plani përveç shqyrtimit të projektligjeve, shqyrtimit të raporteve të organeve të pavarura, monitorimit të ligjeve, Komisioni për herë të parë do të shqyrtojë edhe raportet vjetore, gjashtë e nëntëmujore të shpenzimeve të Ministrive të linjës.

Bekim Haxhiu, tha se Plani i punës së Komisionit përfshin prioritetet për vitin 2016. Ai lidhur me këtë tha se duhet rishikohen afatet kohore, sidomos rreth projektligjeve me rëndësi të veçantë si Projektligji për Arsimin e Lartë dhe Projektligjit për Sponsorizime dhe Donacione në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit. Haxhiu propozoi që Komisioni në planin e punës të përfshijë edhe mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Sportin.

Salih Morina, theksoi se duhet t'i përmbahemi planit të punës së Komisionit në afatet e parapara kohore, dhe shtroi çështjen e raportimit të Ministrisë së Diasporës në Komision, në mënyrë që të rritet bashkëpunimi në mes të kësaj Ministrie dhe Komisionit.

Shpejtim Bulliqi, propozoi që Ligji për Diasporën të përfshihet në planin e punës së Komisionit për mbikëqyrje të zbatimit të tij si dhe përkrahu idenë për raportim të Ministrisë së Diasporës.

Komisioni njëzëri miratoi Planin e Punës së Komisionit, i cili do të përfshihet në Planin e përgjithshëm të punës së Kuvendit të Kosovës.

4. Të ndryshme.

Kryetari i Komisioni i njoftoi anëtarët lidhur me shkresën që i është adresuar Komisionit nga Klubi i Notit ”**Step**”. Komisioni lidhur me këtë shkresë vendosi që në mbledhjen e radhës të ftohen përfaqësues të MKRS-së dhe të Komitetit Olimpik të Kosovës.

Mbledhja përfundoi në orën 14:00.

E përgatiti: ***Njësia për Mbështetjen e Komisionit.***

Kryetari i Komisionit,

Nait Hasani